



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 136, Datë 06.09.2017

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR
PËRCAKTIMIN E PAGESAVE TË RREGULLIMIT PËR TË LICENSUARIT NË
SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 17pika 4, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, dhe nenit 26 të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.09.2017, mbasi shqyrtoi propozimin e Drejtorive Teknike mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullores për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”.

Konstatoi se :

- Referuar nenit 17 pika 4, ERE përcakton dhe miraton pagesën rregullatore që paguhet prej të licencuarve në përputhje me rregulloren përkatëse.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Rregullores për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”.
2. Ngarkohet Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari i ERE
Petrit AHMETI**